



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt.23.08.2021 nga Operatori Ekonomik, N.N.P. “**B-ENGINEERING**”, nga Suhareka, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

Refuzohet - Kërkesa për Rishqyrtim e dt.23.08.2021, parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.P. “**B-ENGINEERING**”, nga Suhareka, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e Aktivitetit të Prokurimit të datës 18.08.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

Vërtetohet - Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 18.08.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

AK – E ka të pezulluar - Aktivitetin e Prokurimit që nga kërkesa për rishqyrtim dhe është e publikuar për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

AK- Qëndron –

prapa Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit sepse kemi vazhduar me hapat e mëtutjeshëm sipas LPP-ës dhe legjisllacionit dytësor të Prokurimit Publik.

Vendimi - hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

- Operatori Ekonomik; N.N.P. “**B-ENGINEERING**”, nga Suhareka, parashtrroi kërkesë për rishqyrtim me dt. 23.08.2021, lidhur me Aktivitetin e “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e Aktivitetit të Prokurimit të datës 18.08.2021.

- Pas analizimit të pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 18.08.2021, konsiderojmë se është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë.

- Duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit shqyrtues të OSHP-së me nr.....të dt.....dhe duke pranuar mendimin e këtij ekspertit shqyrtues të OSHP-së, lënda u kthye në rivlerësim dhe pas rivlerësimit të lëndës nga ana e komisionit e nga i njejti rekomanduar AK, se OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm dhe ka çmimin më të lirë.

- **Autoriteti Kontraktues ka vepruar konforme :**

**Neni 1
Qëllimi**

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

**Neni 6
Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

- Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

**Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

- Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

- Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

**Neni 28
Specifikimet teknike**

- Autoriteti kontraktues do të parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

Neni 60
Kriteret për Dhënie e Kontratës

- Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;


Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

- Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/1-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente në pajtim me nenin 109 të LPP-se

Nr. 14-370-01-0073545/21
Dt. 25.08.2021
Podujevë



Menaxheri ZP
Rasim Fejza